



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA



Pranuar - Pranjeno / Dato <b>23.09.2013</b>			
Nr./ organit Org. broj	Numri/Broj	Shtojcë Prilog	Vlera Vrednost
<b>01-013/823</b>			

Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo

Komuna e Vitisë  
Opština Vitina  
Municipality of Viti/na

Ne bazë të nenit 40.2 pika 1 të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale nr 03/L-40 të Kuvendit të Republikës së Kosovës Gazeta zyrtare nr 28/2008, dhe nenit 35.2 shkronja l) të Statutit të Komunës së Vitisë 01 nr 013/491 të datës 21.04.2011 Kuvendi i Komunës së Vitisë në seancën e mbajtur më 20.09.2013, merr

## V E N D I M

PËR CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR STREHIMIN E QENVE ENDACAK DHE MACAVE  
NË FSHATIN BINÇË TË KOMUNËS SË VITISË

### Neni 1

Me këtë vendim Kuvendi i Komunës së Vitisë, bënë ndarjen dhe CAKTIMIN e lokacionit për strehimin e qenve endacak dhe macave në fshatin Binçë të Komunës së Vitisë.

### Neni 2

Vendi – lokacioni për strehimin e qenve endacak dhe macave nga neni 1 i këtij vendimi caktohet në Z.K. Binçë, në ngastrën kadastrale nr.1840-0 Binçë, pronë e Kuvendit Komunal të Vitisë dhe ka një sipërfaqe prej 89 ari apo 8900 m<sup>2</sup> sipas Çertifikatës mbi të drejtat e pronës së paluajtshme të lëshuar nga Zyra Kadastrale e Komunës së Vitisë më 19.09.2013.

### Neni 3

Vendimi nga neni 1 i këtij Vendimi është miratuar nga Kuvendi i Komunës në bazë të propozimit të Drejtorisë për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural të Komunës së Vitisë.

### Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Kadastër, Pronë dhe Gjeodezi dhe Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural e Komunës së Vitisë.

### Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:

1. Drejtorisë për Bujqësi
2. Drejtorisë për Kadastër
3. Shërbimit të Kuvendit
4. Arkivit

KRYESUESI I KUVENDI  
Skenderbe Hebibi

